



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 20.6.2022

- Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 20.6.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Natasha Prifti (Shallapi)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.9.2021, është njoftuar vendimi nr. 392, datë 28.5.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me anë të të cilit është konfirmuar në detyrë subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnjë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM), në datë 8.9.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit, pasi vlerëson se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar Kolegji).

Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin kundër vendimit nr. 392/2021 të Komisionit, para këtij trupi gjykues, për efekt të këtij gjykimi, parashtron si vijon:

## I. Vlerësimi për kriterin e pasurisë

1. **Lidhur me likuiditetet cash.** Për vlerësimin e saktësisë dhe mjaftueshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash*, Komisioneri Publik mban në vëmendje praktikën e konsoliduar të Kolegjit<sup>1</sup>, i cili ka vlerësuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, në deklaratimet periodike të interesave, është mbizotërues, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila ka parashikuar në mënyrë të posaçme vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore të interesave private. Nisur nga kjo praktikë gjyqësore, në vlerësim të përmbajtjes së deklaratave periodike dhe asaj “Vetting”, për pasurinë në formën e likuiditeteve *cash*, konstatohen rrethanat faktike si më poshtë:

### 2. Lidhur me saktësinë e deklaramit të likuiditeteve *cash*

2.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, nuk kanë deklaruar posedimin e kursimeve *cash*.

2.2 Në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Lekë gjendje në shtëpi, shuma 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

2.3 Në DV-2013, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Gjendje të ardhurash cash, krijuar nga puna në vite, prej vitit 1998. Vlera: 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

2.4 Në DV-2015, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Pakësim i gjendjes së të ardhurave cash (blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare). Vlera: 1.900.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

2.5 Në DV-2016, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Pakësim i kursimeve. Vlera: 1.300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

2.6 Në dosje të Komisionit janë administruar dy procesverbale të mbajtura nga ILDKPKI-ja në datat 29.1.2016 dhe 23.2.2016. Referuar përmbajtjes së procesverbalit të datës 29.1.2016, i pyetur lidhur me gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>2</sup>: [...] *Gjendja cash, në shumën 4.000.000 lekë, vazhdon të jetë në banesë* [...]. Ndërsa në procesverbalin e datës 23.2.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>3</sup>: [...] *Sqaroj se gjendja cash e deklaruar prej meje është pakësuar ndër vite. Deri në datën 31.12.2014, gjendja ka qenë 3.200.000 lekë. Gjatë vitit 2015 është pakësuar sërish gjendja cash, pakësim të cilin do e deklaroj në deklaramin e ardhshëm. Aktualisht, gjendja cash është depozituar në bankë, në shumën 1.300.000 lekë* [...]<sup>4</sup>.

2.7 Për sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ka vlerësuar se: [...] *Ka mospërputhje në deklaramet e subjektit pranë ILDKPKI-së, lidhur me deklaramet e gjendjeve cash, pasi në procesverbalin e mbajtur në datën 29.1.2016, subjekti, fillimisht, deklaroi se gjendja cash prej 4.000.000 lekë është ende në*

<sup>1</sup> Vendimet (JR) nr. 11/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 dhe nr. 27/2020 etj.

<sup>2</sup> Referohuni përgjigjes së pyetjes nr. 6, në procesverbalin e datës 29.1.2016.

<sup>3</sup> Referohuni përgjigjes së pyetjes nr. 6, në procesverbalin e datës 23.2.2016.

<sup>4</sup> Në këtë procesverbal, subjekti ka deklaruar se në vitin 2013 ka harruar të deklarojë shpenzimet në shumën 600.000 lekë, nga kursimet e tij. Po ashtu, edhe për vitin 2014, ka harruar të deklarojë shpenzimet në shumën 800.000 lekë, pakësim nga gjendja *cash* e bashkëshortit.

*banesë, ndërkohë që në procesverbalin e mbajtur në datën 23.2.2016, subjekti deklaroi se shuma prej 4.000.000 lekë është pakësuar ndër vite [...].*

2.8 Komisioni, pasi ka administruar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare, për sa kohë që ky pakësim nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, por çmon të theksojë se subjekti e ka deklaruar vullnetarisht këtë pasaktësi në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 23.2.2016 ... dhe se kjo ndreqje bën që gjendja e likuiditeteve cash në Deklaratën “Vetting” të jetë zero, çka përputhet me deklarin e subjektit në këtë deklaratë [...]*<sup>5</sup>.

**3.** Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 8.9.2021<sup>6</sup>, ndan qëndrim të ndryshëm nga përfundimi i arritur nga Komisioni, lidhur me saktësinë e deklarin për likuiditetet *cash*, duke konstatuar situatën faktike si vijon:

3.1 Bazuar në deklaratat periodike vjetore rezultojn se: (i) Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 600.000 lekë, ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklarin e tij të parë, në DV-2013, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 4.000.000 lekë. (ii) Si subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti, nuk rezultojn të kenë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008-2014. (iii) Në DV-2015 dhe DV-2016 deklarohet pakësimi i likuiditeteve *cash*, në total në shumën 3.200.000 lekë<sup>7</sup>. (iv) Bazuar në këto deklarime, gjendja e likuiditeteve *cash*, në datën 31.12.2016, llogaritet në vlerën 1.400.000 lekë.

3.2 Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, datë 29.1.2016, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* prej 4.000.000 lekë është ende në banesë, ndërsa në DV-2015, dorëzuar në ILDKPKI, në datë \*\*.3.2016, pra pas mbajtjes së këtij procesverbali, deklarohet nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, pakësim i kursimeve *cash* gjatë vitit 2015, në shumën 1.900.000 lekë.

3.3 Sa më sipër, rezultojn se: (i) Ka mospërputhje lidhur me likuiditetet *cash* të deklaruara, pasi bazuar në deklaratat periodike vjetore, gjendja e likuiditeteve *cash* në momentin e dorëzimit të Deklaratës “Vetting” duhet të jetë 1.400.000 lekë<sup>8</sup>, ndërkohë që në Deklaratën “Vetting” nuk deklarohen kursime *cash*; (ii) Ka deklarime kontradiktore në procesverbalet e ILDKPKI-së, të mbajtura brenda një harku të shkurtër kohor lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, pasi në procesverbalin e datës 29.1.2016, deklarohet se gjendja *cash* prej 4.000.000 lekë është ende në banesë, ndërsa në procesverbalin e datës 23.2.2016, deklarohet se aktualisht gjendja *cash*, në shumën 1.300.000 lekë, është depozituar në bankë.

<sup>5</sup> Referohuni arsytimit të Komisionit f. 35 e vendimit.

<sup>6</sup> Referohuni rekomandimit të ONM-së, datë 8.9.2021, prg. A) 5.

<sup>7</sup> Në DV-2015, pakësuar me 1.900.000 lekë dhe në DV-2016, pakësuar me 1.300.000 lekë.

<sup>8</sup> Shuma 1.400.000 lekë përbëhet nga shuma 600.000 lekë kursime *cash*, të deklaruara nga subjekti dhe 800.000 lekë kursime *cash*, të mbetura nga *cash*-i i deklaruar nga personi i lidhur.

3.4 Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>9</sup>, në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private, periodike vjetore, konsideruar si provë parësore, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat së bashku me Deklaratën “Vetting” përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit, vlerësojmë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket vlerës së *cash*-it jashtë sistemit bankar, në vite të ndryshme, apo dinamikës së përdorimit të tyre, për të mbuluar shpenzime të caktuara, mbetën në nivel deklarativ dhe jo të besueshme.

3.5 Përveç sa më sipër, deklaratimet kontradiktore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me likuiditetet *cash*, krijojnë pamundësi në verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive të rrjedhura prej tyre. Më konkretisht, lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, në datën 31.12.2015, rezulton se, nëse gjendja e tyre do të ishte në shumën 4.000.000 lekë, siç deklarohet nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e datës 29.1.2016, që daton edhe para dorëzimit të DV-2015, atëherë kjo do të ndikonte në rezultatin e analizës financiare për vitin 2015, duke sjellë pamjaftueshmëri financiare<sup>10</sup>.

3.6 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, përcaktohet detyrimi i zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash* dhe jo të nënkuptohet ekzistenca apo ndryshimi i tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte saktësisht dhe plotësisht pasurinë, në rastin konkret likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, duke shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me likuiditetet *cash*, duke pamundësuar verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të rrjedhura prej tyre.

#### **4. Në lidhje me mjaftueshmërinë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 4.000.000 lekë**

4.1 Në DV-2013, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: Gjendje të ardhurash *cash*, krijuar nga puna në vite, prej vitit 1998, në shumën 4.000.000 lekë.

4.2 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit konstatojmë se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me z. \*\*\*.\*\*\*, në datën \*\*.5.2013, dhe njohja mes tyre rezulton prej vitit 2010 (udhëtime së bashku dhe përdorim makine). Në pyetësorin standard, i pyetur nga Komisioni, lidhur me bashkëjetesën dhe shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshortin, z. \*\*\*.\*\*\*, në janar të vitit 2012 dhe shpenzimet janë përballuar bashkërisht.

<sup>9</sup> Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 27/2020.

<sup>10</sup> Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2015 nuk është konstatuar pamjaftueshmëri, por vërejmë se në këtë analizë financiare Komisioni ka pakësuar likuiditetet *cash*, në shumën 1.900.000 lekë. Nëse nuk do të pakësoheshin këto likuiditete, sikundër është deklaruar nga subjekti në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 29.1.2016, viti 2015 do të rezultonte me një pamjaftueshmëri financiare në vlerën -1.624.103 lekë.

4.3 Në këto kushte, Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara në DV- 2013, përfshirë këtu edhe kursimet *cash* në shumën 4.000.000 lekë, duke marrë në konsideratë: (i) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e bashkëshortit për periudhën 2001 – 2013, si dhe (ii) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit për periudhën 2012 – 2013<sup>11</sup>. Nga analiza financiare për periudhën 2001-2013 ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pasurive dhe shtesën e kursimeve, në vlerën - 3.460.498 lekë, e për rrjedhojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

4.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka pretenduar se fitimi mesatar i realizuar nga aktiviteti i bashkëshortit është më i lartë nga sa është llogaritur nga Komisioni.

4.5 Komisioni, në konsideratë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, ka rishikuar analizën financiare, nga ku ka rezultuar një pamjaftueshmëri financiare në vlerën -1.648.646 lekë<sup>12</sup>. Në vijim, Komisioni ka mbajtur në konsideratë, gjithashtu, faktin se nga hetimi i kryer, subjekti dhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën *cash* prej 4.000.000 lekësh, për të investuar në të tjera pasuri, gjë e cila do të çonte në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, përveçse për blerjen e automjetit, me targa: \*\*\*.

4.6 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *Mungesa e të ardhurave financiare, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në shumën prej -1.648.646 lekësh, për krijimin jo vetëm të pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2013 (përpara martesës ligjore), por edhe të blerjes së pasurive të tjera dhe kryerjes së shpenzimeve përpara vitit 2013, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 13-vjeçare (2001 – 2013), faktet dhe provat rrethanore, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të krijojnë bindjen se kjo mungesë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe të përbëjnë, për pasojë, një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra [...]*<sup>13</sup>.

5. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 8.9.2021<sup>14</sup>, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, duke konstatuar situatën faktike si vijon:

5.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka nisur bashkëjetesën me z. \*\*\*.\*\*\* në janar të vitit 2012, si rezultat edhe Komisioni, në analizë të burimit të ligjshëm të këtyre likuiditeteve, ka konsideruar në analizën financiare të ardhurat e realizuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë viteve

<sup>11</sup> Periudhë gjatë së cilës subjekti ka deklaruar se ka bashkëjetuar me shtetasin \*\*\*.\*\*\*.

<sup>12</sup> Komisioni ka vlerësuar të aplikojë një marzh fitimi në masën 25,54%, për vitet 2001 – 2006, vite për të cilat nuk ka informacion nga organet kompetente. Ndërkohë që, pavarësisht se në raportin e audituesit ligjor është aplikuar norma e fitimit 25,54 % edhe në vitet për të cilët ka të dhëna, Komisioni vlerësoi që fitimi për këto vite të mbetet i pandryshuar, në shumën totale prej 2.042.120 lekësh, për sa kohë që Bashkia Lushnjë, për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013, ka përcjellë informacion të mjaftueshëm për përcaktimin e fitimit. Ndërsa për vitin 2011, Komisioni vlerësoi të aplikojë një normë fitimi prej 23,82 %, si mesatare e normës së fitimit të vitit paraardhës dhe vitit pasardhës, dhe përlllogarit një fitim në shumën 416.815 lekë.

<sup>13</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 21 të vendimit.

<sup>14</sup> Referohuni Rekomandimit të ONM-së, prg. A) 1, 2, 3, 4, 5.

2012-2013. Pra, pamjaftueshmëria e konstatuar nga Komisioni lidhet edhe me pasuri të krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, gjatë bashkëjetesës dhe martesës së tyre.

5.2 Gjithashtu, rezulton se, megjithëse Komisioni në analizën financiare përfundimtare ka pranuar të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me një marzh më të lartë fitimi nga aktiviteti tregtar i z. \*\*\*.\*\*\*, sërish ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën - 1.648.646 lekë, për pasuritë e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në DV-2013.

6. Komisioneri Publik vlerëson të pambështetur në prova përfundimin e arritur nga Komisioni, se nga hetimi i kryer, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën *cash* prej 4.000.000 lekësh, për të investuar në pasuri të tjera, përveçse për blerjen e automjetit me targë: \*\*\*. Bazuar në aktet e administruara në fashikull, konstatohet se këto kursime *cash* kanë shërbyer si burim krijimi për pasuri të krijuara pas martesës së subjektit të rivlerësimit me z. \*\*\*.\*\*\*, më konkretisht:

6.1 *Automjeti tip Mercedes Benz, me targa: \*\*\**

6.1.1 Në D-Vett., personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar pasurinë automjet furgon, tip Mercedes Benz, me targë: \*\*\*, blerë sipas kontratës së shitjes datë \*\*.10.2015, me vlerë 8.400 euro, me burim krijimi të ardhurat nga biznesi ndër vite.

6.1.2 Në DV-2015, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, e ka deklaruar këtë automjet me burim krijimi kursimet personale, si dhe ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 1.900.000 lekë, për blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare.

6.1.3 Nga aktet e administruara në dosje<sup>15</sup> rezulton se ky automjet është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me anë të faturës tatimore të shitjes nr. \*\*\*, datë \*\*.10.2015, në vlerën 8.400 euro, dhe si burim krijimi, bazuar në deklaratimet e personit të lidhur, kanë shërbyer likuiditet *cash*, të deklaruara në DV-2013.

6.2 *Llogari bankare në \*\*\* Bank, në shumën 1.300.000 lekë*

6.2.1 Nga informacioni i përcjellë nga \*\*\* Bank<sup>16</sup>, rezulton se, në datën \*\*.2.2016, është depozituar *cash* nga z. \*\*\*.\*\*\*, në llogarinë e tij bankare, pranë kësaj banke, shuma 1.300.000 lekë dhe rreth 1 muaj më vonë, në datën \*\*.3.2016, kjo shumë është tërhequr nga llogaria.

6.2.2 Kjo llogari bankare dhe burimi i krijimit të saj nuk rezulton që të jenë deklaruar në DV-2016, ndërsa në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI, në datën 23.2.2016, subjekti ka deklaruar si vijon: [...] *Aktualisht gjendja cash është depozituar në bankë në shumën 1.300.000 lekë.*

6.2.3 Sa më sipër, edhe pse këto fonde janë depozituar dhe tërhequr nga banka në një periudhë të shkurtër kohore përpara plotësimit të Deklaratës “Vetting”, rezulton se si burim krijimi kanë shërbyer likuiditet *cash* të deklaruara nga personi i lidhur në DV-2013.

6.3 *Llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, në \*\*\* Bank, me balancë në datën 31.12.2016, në shumën 1.774.148,61 lekë.*

<sup>15</sup> Referohuni akteve të përcjella bashkëngjitur shkresës së DPSHTRR-së nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019.

<sup>16</sup> Referohuni informacionit të përcjellë nga \*\*\* Bank, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019.

6.3.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogarinë rrjedhëse pranë \*\*\* Bank, të krijuar me të ardhurat nga kursimet nga puna dhe bursa prej vitit 2004, në vlerën 1.316.666 lekë.

6.3.2 Nga informacioni i përcjellë nga \*\*\* Bank<sup>17</sup>, rezulton se balanca e kësaj llogarie, në datën 31.12.2016, është në shumën 1.774.148.61 lekë. Kursimet në këtë llogari bankare janë krijuar gjatë periudhës 2012-2016 dhe kanë si burim të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit. Rezulton se në vitin 2015, nga të ardhurat e realizuara nga punësimi i subjektit në shumën totale prej 922.298 lekësh, janë shtuar likuiditete në llogarinë bankare të subjektit në shumën 736.143 lekë.

6.3.3 Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë se pjesa më e madhe e të ardhurave nga paga e subjektit kanë shërbyer për shtimin e likuiditeteve në këtë llogari bankare, rezulton se kursimi i kësaj shume është bërë i mundur nga pakësimi i likuiditeteve *cash*, siç është deklaruar përkatësisht në DV-2015.

6.4 *Llogari bankare në \*\*\* Bank, në shumën 1.505,1 euro*

6.4.1 Në D-Vett. dhe DV-2016, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar llogari bankare në \*\*\* Bank, në shumën 1.505,1 euro, me burim kurse nga të ardhurat e krijuar nga puna. Gjithashtu në DV-2016, ky i fundit ka deklaruar se kjo llogari bankare është krijuar në vitin 2015, por është harruar të pasqyrohet në deklaratën paraardhëse.

6.4.2 Nga informacioni i përcjellë nga \*\*\* Bank<sup>18</sup>, rezulton se, në datën \*\*.4.2015, është depozituar *cash* nga z. \*\*\*.\*\*\*, në llogarinë e tij bankare, shuma 1.500 euro, ndërkohë që rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, për periudhën \*\*.1.2015 - \*\*.4.2015<sup>19</sup>, nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve familjare dhe për të kursyer shumën 1.500 euro. Për rrjedhojë, duket se krijimi i kësaj llogarie bankare rrjedh nga pakësimi i likuiditeteve *cash*.

6.5 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë likuiditete *cash*, pasi nuk mbulon plotësisht me burime të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara në DV- 2013, rrjedhimisht, edhe pasuritë me burim krijimi nga këto kurse, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

7. Komisioneri Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 8.9.2021, vlerëson, gjithashtu, se arsyetimi i Komisionit mbi bazën e parimit të “proporcionalitetit”, lidhur me pasaktësitë dhe pamjaftueshmërinë e konstatuar, duket se nuk gjen mbështetje në kuadrin kushtetues dhe ligjor. Në thelb, parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit synojnë që në shqyrtimin e çështjes, në përfundim, vendimmarrja të respektojë një balancë të justifikueshme, ndërmjet fakteve të konstatuara, rëndësisë së tyre dhe masës disiplinore përkatëse. Në analizë të situatës faktike të konstatuar, pasaktësitë dhe pamjaftueshmëria financiare e vërejtur, konstatojmë

<sup>17</sup> Referohuni informacionit të përcjellë nga \*\*\* Bank, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019.

<sup>18</sup> Referohuni informacionit të përcjellë nga \*\*\* Bank, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019.

<sup>19</sup> Referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, rezulton se subjekti gjatë kësaj periudhe ka tërhequr *cash* nga llogaria e tij në \*\*\* Bank, në total, shumën 58.000 lekë, ndërsa fitimi i bashkëshortit për këtë periudhë llogaritet në shumën rreth 100.000 lekë.

se Kolegji, në raste të ngjashme, në lidhje me zbatimin e parimit të proporcionalitetit, ka vlerësuar se: [...] 22.7 Nga analizimi dhe interpretimi i dispozitave të cituara me sipër lidhur me parimin e proporcionalitetit, Kolegji arsyeton se në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, parimi i proporcionalitetit është një nga tërësia e parimeve, nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit, dhe nuk mund të merret si parim i shkëputur për të mbuluar pasaktësitë dhe pamjaftueshmëritë e subjekteve të rivlerësimit në deklaratime [...]<sup>20</sup>.

**8.** Komisioneri Publik, përveç sa më sipër trajtuar, konstaton se Komisioni ka marrë në vlerësim edhe pasurinë *Automjet tip Mercedes Benz, me targa: \*\*\**.

8.1 Për këtë pasuri rezulton se në DV-2014, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: Blerje automjeti Mercedes Benz, në Gjermani, me targë: \*\*\*. Vlera 4300 euro dhe pagesa për doganën 383.000 lekë. Nuk deklarohet burimi i krijimit. Pjesa takuese 100%.

8.2 Nga hetimi administrativ, Komisioni, ndër të tjera, për këtë pasuri ka konstatuar se: (i) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën \*\*.4.2014, me një balancë negative prej -1.386.783 lekësh; (ii) Subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2014, me një balancë negative prej -352.255 lekë; (iii) Ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti.

8.3 Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka vlerësuar që pretendimi i subjektit, se për blerjen e automjetit janë përdorur likuiditetet *cash* të disponuara në fund të vitit 2013, është i bazuar. Më tej, Komisioni ka konstatuar se, në fund të vitit 2014, gjendja *cash* ka mbetur e pandryshuar, pasi subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar në deklaratën periodike vjetore ndryshime të likuiditeteve *cash*. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti dhe personi i lidhur me të rezultojnë me një mungesë burimesh të ligjshme, në vlerën - 352.255 lekë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2014.

**9.** Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pasuritë në pronësi dhe burimin e krijimit të tyre. Nga analizimi i deklaratës periodike për vitin 2014, nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie apo pakësimi i likuiditeteve *cash* të disponuara. Për rrjedhojë, sikurse dhe Komisioni ka konstatuar, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare në momentin e blerjes së kësaj pasurie, në shumën prej -1.386.783 lekë.

9.1 Në kuadrin e kontrollit të kriterit të pasurisë dhe vlerësimit tërësor të çështjes, pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në krijimin e kësaj pasurie do të rezultonte edhe nëse marrim në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit: “... se mosndryshimi i gjendjes *cash*

---

<sup>20</sup> Vendimi (JR) nr. 20/2020.



*nuk do të thotë se gjatë vitit kjo gjendje nuk ka ndryshuar...”, në fund të vitit 2014, për një diferencë negative në vlerën - 352.255 lekë.*

9.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. Kërkimi i ankimit**

**10.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

**11.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**12.** Në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**